



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 09 Qershor 2021

Nr: 394

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALLAKASTËR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË DEMOKRACIA SOCIALE,
ZJ. GURJETA TAJAR BRAKAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 1192 prot., datë 06.05.2021, këshilli i bashkisë Mallakastër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Natirda Dritan Aliaj, për shkak të mosparaqitjes në mbledhjen e këshillit, për marrjen e mandatit dhe kryerjen e betimit, propozuar nga Partia Demokracia Sociale.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokracia Sociale, për këshillin e bashkisë Mallakastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 16, zj. Gurjeta Tajar Brakaj.

Me shkresën nr. 5116 prot., datë 11.05.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, zj. Gurjeta Tajar Brakaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Demokracia Sociale, ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2165 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Gurjeta Tajar Brakaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, rezulton se, se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 5453 prot., datë 25.05.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 5452 prot., datë 25.05.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Gurjeta Tajar Brakaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1987/1 prot., datë 04.06.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, zj. Gurjeta Tajar Brakaj, e cila rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 5390/1 prot., datë 28.05.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Gurjeta Tajar Brakaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Gurjeta Tajar Brakaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



V E N D O S:

1. Zj. Gurjeta Tajar Brakaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale, zj. Gurjeta Tajar Brakaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

